



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 23.4a.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË FONDEVE NË
MIRËBESIM
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondeve në Mirëbesim, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Vlora Mehmeti e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Bahri Statovci dhe anëtares së ekipit Liridona Berisha, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Enver Boqolli.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	20
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	21
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	24
Shtojca IV: Komentet e OB-së për të gjeturat e raportit të auditimit.....	26
Aneksi V: Letër konfirmimi.....	30

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave financiare vjetore të Fondeve në Mirëbesim për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 17.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore përveç çështjes së shpenzimeve për Ofruesit e Shërbimeve Profesionale të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore të privatizuara të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të kualifikuar, pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Kualifikimi i opinionit pasqyron mos pajtueshmërinë e pagesave për Ofruesin e shërbimeve profesionale nga Fondet në Mirëbesim. Këto pagesa sipas ligjit të Agjencisë Kosovare në Privatizim duhet të bëhen nga buxheti i ndarë për AKP-në.



Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme që pagesat e Ofruesit të shërbimeve profesionale të bëhen nga buxheti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Procesi i përgatitjes së PFV-ve ka pasur disa përmirësime krahasuar me vitet e kaluara, megjithatë edhe këtë vit opinioni është i kualifikuar për çështjen e njëjtë sikurse në vitin paraprak.



Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV për 2017 të inkorporojë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv dhe të nënshkruhet vetëm pasi janë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme.

Rekomandimet e vitit paraprak nuk ishin adresuar ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e menaxhimit të Fondeve në Mirëbesim.



Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive (shih çështjen 3).

Aranzhimet e qeverisjes, llogaridhënies dhe raportimit menaxherial janë të dobëta.



Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të sigurojë që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për të siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial. (shih çështjen 4).

Në fushën e të hyrave, në procesin e likuidimit të portfolios së NSH-ve, shkallë e ulët e llogarive të arkëtueshme.



Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të aplikojë një vlerësim të detajuar të procesit të likuidimit dhe fushave tjera të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 5 deri tek 10).

AKP ka marrë në konsideratë të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e AKP për çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar janë dhënë në detaje në Shtojcën IV.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) për Fondet në Mirëbesim (FM) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe Zyrtarit Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Fondeve në Mirëbesim për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes së Fondeve në Mirëbesim, gjendjen e llogarive bankare të Fondeve në Mirëbesim, llogaritë e arkëtueshme, llogarit e pagueshme dhe detyrimet kontigjente.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, PFV e Fondeve në Mirëbesim për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjin nr. 04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nenin 20 Pasqyrat financiare të llogarive dhe asetëve të cilat mbahen nga Agjencia në mirëbesim dhe Rregullores së AKP-së për kornizën raportuese të pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim.

Baza për opinion të kualifikuar

Pagesat për Ofruesin e Shërbimeve Profesionale (OSHP) për vitin 2016 në vlerë prej 3,713,028€ ishin bërë nga Fondet në Mirëbesim. Bazuar në ligjin e AKP-së sipas nenit 16, kompensimi i ofruesve të shërbimeve profesionale kryhet nga mjetet që i janë ndarë Agjencisë nga Buxheti i Republikës së Kosovës ose nga mjetet e siguruar nga një donator.

Për këtë arsye ne kemi kualifikuar opinionin tonë.

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga AKP dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori menaxhues i AKP-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të FM sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik-Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve (BD) është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AKP-së për FM.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

AKP kërkohet të raportoj për menaxhimin e FM-së në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysht:

- Kërkesat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Rregulloren për kornizën raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim;
- Politikën operationale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Raportet tre mujore, dhe pasqyrat financiare nëntëmujore; si dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.
- Marrë parasysht çka u tha më lartë tek nën kapitulli Opinioni i Auditimit dhe çështjeve të prezantuara në vijim, Deklarata e bërë nga Drejtori menaxhues i AKP-së dhe ud. Drejtori i Financave dhe Buxhetit, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Qeveri, mund të konsiderohen të sakta përveç çështjes që është cekur tek baza për opinion.

Çështja 1 - Përpilimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të FM-së - Prioritet i mesëm

E gjetura Krahasuar me vitet e kaluara, në hartimin e PFV-ve të FM-së kishte përmirësime, megjithatë ende është e nevojshme të bëhen përmirësime të mëtejme.

Ne kemi trajtuar cilësinë e informacioneve të prezantuara në PFV-të për FM dhe kemi konstatuar se të dhënat e prezantuara në PFV-të për gjendjen e FM nuk ishin harmonizuar me raportin e departamentit të shitjes me 31 dhjetor 2016. Raporti i departamentit të shitjes kishte diferencat në vijim në krahasim me PFV: llogaritë e të hyrave nga shitja ishin nënvlerësuar për 254€; llogaritë e të hyrave nga qiratë ishin mbivlerësuar për 14,493€; të hyrat tjera ishin nënvlerësuar për 14,220€; pagesat e OSHP-së ishin mbivlerësuar për 22,628€; mallrat dhe shërbimet ishin nënvlerësuar për 21,671€; dhe shpenzimet e tjera ishin nënvlerësuar për 501€.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Rekomandimi 1 **Prioritet i lartë** – Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat e OSHP-së të bëhen nga buxheti i ndarë për Agjencinë.

Rekomandimi 2 **Prioritet i lartë** – Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Drejtori Menaxhues dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për AKP-në lidhur me FM që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim fushave të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm dhe fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuarra përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda AKP-së për menaxhimin e FM veçanërisht në lidhje me llogaridhënien dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe raportim të saktë nga departamentet, nuk janë të vendosura.

Qeverisja e FM në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, si dhe menaxhimin e rrezikut nuk ka siguruar që sistemet financiare funksionojnë në mënyrë të duhur. AKP ka zbatuar pjesërisht rekomandimet si dhe ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek menaxhimi i FM në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

Në këtë aspekt, inkurajojmë menaxhmentin e AKP-së të marr në konsideratë përfitimin nga puna e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për të ngritur nivelin e kontrolleve në fushat me mangësi të theksuara.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2015 për FM kishte rezultuar me 8 (tetë) rekomandime. AKP kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Po ashtu, në takimet e BD-së ishte diskutuar për adresimin e rekomandimeve, megjithatë menaxhmenti, nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i rekomandimeve monitorohet formalisht.

Çështja 3 – Zbatimi i ulët i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të AKP-së ka rezultuar në 8 (tetë) rekomandime² të FM. AKP kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, vetëm 2 (dy) rekomandime ishin zbatuar, 3 (tri) ishin zbatuar pjesërisht, ndërsa 3 (tri) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim me të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato shihni shtojcën III.

Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse nuk është ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake në nivel të duhur pamundëson zhvillimin e proceseve për arritjen e objektivave në mënyrë efektive.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.2 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit AKP menaxhon FM dhe sfidat me të cilat përballlet.

² Në raportin e auditimit të vitit 2015 ZKA kishte dhënë 24 rekomandime duke përfshirë PFV-të e Agjencisë dhe PFV-të e Fondeve në Mirëbesim, por këtë vit këto dy palë PFV do të auditohen dhe raportohen ndaras. Ne vlerësuam se 16 rekomandime i takojnë auditimit të PFV-ve të Agjencisë, ndërsa 8 rekomandime i takojnë PFV-ve të Fondeve në Mirëbesim.

2.2.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti kishte zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 4 – Mangësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të AKP-së për menaxhimin e FM-së në disa raste ka nxjerrë në pah se kontrollet e brendshme nuk ishin aplikuar në masën e duhur për parandalimin e gabimeve gjatë vitit 2016. Me theks të veçantë, kontrollet nuk ishin efektive aq sa duhet në fushën e shpenzimeve për pagesat e OSHP-së, , përgatitjes së PFV-ve, arkëtimin e të hyrave nga qiratë, arkëtimin nga llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme.
- Rreziku** Mungesa e llogaridhënies dhe raportimit financiar reduktojnë efektivitetin e menaxhimit të FM, identifikimin dhe përmirësimin e dobësive, që mund të shkaktojnë gabime financiare dhe vonesa në arritjen e objektivave të synuara të AKP-së.
- Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarr veprimet e nevojshme për përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave të synuara të AKP-së brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

2.3 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me drejtorin, dy auditor dhe një zyrtar administrativ. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të AKP-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruara nga një Komitet i Auditimit efektiv.

NjAB kishte hartuar planin e punës duke u bazuar në strategjinë për periudhën kohore 2014-2016 të AKP-së. Për vitin 2016, kishte planifikuar 5 (pesë) auditime³ për FM. Gjatë vitit 2016, kishte përgatitur 7 (shtatë) raporte për FM, prej tyre 2 (dy) kishin mbuluar aktivitetet e vitit 2015. NjAB kishte dhënë rekomandime të rëndësishme menaxhmentit për përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm. Menaxhmenti i AKP-së ka përgatitur planet e veprimit për implementimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm. Në vitin 2016, ishte themeluar dhe funksionalizuar Komiteti i Auditimit, i cili kishte mbajtur 4 (katër) takime dhe kishte shqyrtuar raportet e finalizuara nga NjAB dhe raportin e auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

³NjAB kishte planifikuar gjithsejtë 8 auditime, por 5 prej tyre mbulonin aktivitetet e menaxhimit të Fondeve në Mirëbesim, ndërsa 3 auditime tjera mbulonin aktivitetet e menaxhimit të Agjencisë si Organizatë Buxhetore.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në menaxhimin e FM.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të FM-së kanë nevojë për përmirësime. Shfrytëzimi i mjeteve të FM-së për pagesat e OSHP-së të cilat sipas Ligjit duhet të kryhen nga buxheti i AKP-së është çështje e cila kërkon trajtim të veçantë nga menaxhmenti i AKP-së. Po ashtu, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi nuk janë në nivelin e duhur dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Me theks të veçantë, kontrollet ekzistuese në zbatimin e rregullores së qiradhënies së aseteve të NSH-ve duhet të përmirësohen.

Më tutje, niveli i ulët i përmbushjes së procesit të likuidimit deri me 31 dhjetor 2016, dhe pengesat e paraqitura, kanë rritur rrezikun që procesi mos të finalizohet në afatin e përcaktuar kontraktual. Kjo ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve si dhe në përmbushjen e misionit të AKP-së. Si pasojë e mos përmbushjes me kohë të procesit të likuidimit, AKP kishte lidhur aneks kontrata për të vazhduar me procesin e likuidimit. .

Llogaritë e arkëtueshme kishin trend të rritjes edhe gjatë vitit 2016, përkundër rritjes së tyre BD i AKP-së nuk kishte marrë veprimet e nevojshme për trajtimin e llogarive të arkëtueshme, arkëtimin e tyre, apo ndarjen e provizioneve për to.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga menaxhmenti i AKP-së për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin në FM.

3.1 Menaxhimi i Buxhetit të Fondeve në Mirëbesim

Bazuar në ligjin Nr. 04/L-034 për AKP, Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet, dhe pronën që bie nën fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2 ky autoritet përfshin çdo veprim që Agjencia e konsideron të arsyeshëm dhe të duhur brenda kufijve administrativ të Agjencisë, për të mundësuar shitjen, likuidimin dhe transferimin apo ndonjë zgjedhje tjetër për ndërmarrjet, asetet apo interesat në pronësi shtetërore. Ne kemi shqyrtuar gjendjen e llogarive bankare të pranimeve dhe shpërndarjes/shpenzimeve të FM. Kjo është paraqitur në tabelën 1.

Tabela 1. Pasqyra e Gjendjes së Fondeve në Mirëbesim në €

Përshkrimi	Gjendja e llogarive me 31.12.2015	Pranimet/shpenzimet gjatë 2016-s	Gjendja e llogarive 31.12.2016
Pranimet			
Të hyrat nga shitjet	664,937,929	1,144,120	666,082,049
Të hyrat nga qiraja	14,875,555	6,137,570	21,013,125
Qiraja nga komercializimi	5,021,319	-	5,021,319
Interesi i fituar	34,844,700	-	34,844,700
Tarifa për pjesëmarrje në tenderët e shitjes	7,512,464	657,420	8,169,884
Të hyrat tjera	5,123,100	1,584,217	6,707,317
Kapitali themeltar i Agjencisë	1,013,200	-	1,013,200
Gjithsej pranimet	733,328,267	9,523,327	742,851,594
Shpenzimet / Shpërndarja			
20% i punëtorëve i transferuar në BSPK	104,245,154	5,728,413	109,973,567
Ofruesi i shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)	10,710,902	3,713,028	14,423,930
Mallra dhe shërbime	9,796,874	2,389,461	12,186,335
Shërbime Publike	827,690	435,117	1,262,807
Tatimet	2,358,023	930,582	3,288,605
Vendimet e Gjykatave/ përmbauesve	1,740,000	34,806	1,774,806
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-se	25,848,000	6,300,000	32,148,000
Të tjera	692,348	22,907	715,255
Pagesat ndaj kreditorëve të NSH-së	45,140	15,826,888	15,872,028
Fondet tepriçë transferuar qeverisë	90,244,911	-	90,244,911
Gjithsej Shpenzimet /Shpërndarja	246,509,042	35,381,202	281,890,244
Gjendja Bankare	486,819,224	(25,857,875)	460,961,350

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur pranimet, shpenzimet/shpërndarjet dhe gjendja bankare e fondeve në mirëbesim me datën 31 Dhjetor 2016. Çështjet lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga FM për shpenzimet e OSHP-së janë prezantuar tek nënkapitulli i Opinioneve të Auditimit.

3.2 Pranimet / të hyrat

3.2.1 Të hyrat nga qiratë

Të hyrat nga qiratë realizohen nga dhënia e aseteve me qira të NSH-ve në tranzicion dhe në likuidim. Për periudhën raportuese të hyrat nga qiratë ishin realizuar 6,137,570€, ndërsa në vitin paraprak ishin realizuar 4,796,952€ respektivisht 1,340,618 € më shumë.

Çështja 5 – Menaxhimi jo i mirë i të hyrave nga qiratë – Prioritet i lartë

E gjetura Menaxhmenti nuk kishte zbatuar kontrollet ekzistuese në mënyrë efektive për të siguruar zbatimin e rregullores së qiradhënies së aseteve të NSH-ve dhe kushtet e përcaktuara në kontrata. Mangësitë e identifikuar janë prezantuar në vijim:

- Sipas rregullores për qiradhënien e aseteve të NSH-ve, kërkohet që lista e propozimeve për qiradhënie të dërgohet te BD për miratim. Pas miratimit të BD, asetet do të lëshohen me qira përbrenda afatit optimal të vendosur nga menaxhmenti. Në 18 raste kontratat për qiradhënie ishin nënshkruar pa miratimin nga BD.
- Në 11 raste ishin nënshkruar kontrata për qira me qiramarrësit pa i kryer obligimet e papaguara për kontratat paraprake.
- Në 1 (një) rast qiramarrësi nuk kishte nënshkruar vazhdimin e kontratës, përderisa kishte vazhduar që të shfrytëzojë objektin, por kishte vazhduar që të bëjë pagesat; dhe

Departamenti i koordinimit rajonal edhe pse kishte progres në mbledhjen e qirasë, nuk ishte në gjendje të ofrojë raport përmbledhës për gjendjen e qirave me 31dhjetor 2016.

Rreziku Mos funksionimi i sistemit të kontrolleve rrit rrezikun e keq menaxhimit të të hyrave nga qiratë dhe të aseteve të NSH-ve, gjithashtu ndikon në rritjen e llogarive të arkëtueshme nga qiratë.

Rekomandimi 5 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për të adresuar, si çështje urgjente, menaxhimin e aseteve të NSH-ve dhe të hyrave nga qiratë në pajtueshmëri me rregulloren për dhënie me qira.

3.3 Shpenzimet / shpërndarja

3.3.1 Ofruesi i shërbimeve profesionale

Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (OSHP) shërben si autoritet likuidues për likuidimin e portfolios së NSH-ve dhe shqyrtimin e pretendimeve të kreditorëve.

Gjithsej vlera e pagesave për OSHP nga 10 korrik 2012 deri me 31 dhjetor 2016 ishte 14,423,930€, nga kjo 3,713,028€ ishin për periudhën janar-dhjetor 2016.

Çështja 6 - Procesi i likuidimit të portfolios së NSH-ve nuk ishte kryer në afatin e kontraktuar me kontratën bazë - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas kontratës, OSHP kishte për obligim që të përmbyll procesin për likuidimin e të gjitha NSH-ve nën administrimin e AKP-së deri me datën 10 korrik 2016, gjë që nuk kishte arrit të bëjë, kështu që AKP kishte nënshkruar aneks kontratën me të njëjtin OSHP edhe për dy vite.

Numri i NSH-ve nën administrimin e AKP-së sipas raportit vjetor të AKP-së për vitin 2016 ishte gjithsej 541 NSH. Nga fillimi i procesit të likuidimit deri në 31 dhjetor 2016 ishin gjithsej 463 NSH që kanë hyrë në procesin e likuidimit.

NSH të mbyllura sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) të cilat ishin pa ankesa apo kërkesa të kreditorëve ishin 12 NSH.

Autoriteti i likuidimit për NSH-të në likuidim kishte përgatitur raportet e shpërndarjes së mjeteve tek kreditorët e ligjshëm për 117 NSH, të cilat janë në proces të ekzekutimit, si në vijim:

- Për 96 NSH ishin përgatitur raporte të shpërndarjes së përkohshme⁴; dhe
- Për 21 NSH ishin përgatitur raportet përfundimtare⁵.

Pengesat kryesore për vonesat në përmbylljen e procesit të likuidimit të NSH-ve, kryesisht ishin për shkak të mungesës së emërimit të BD-së⁶ dhe vonesave gjatë trajtimit të lëndëve nga DHPGJSK.

⁴ Raporte e shpërndarjes së përkohshme – përgatiten atëherë kur nuk është e mundur të përgatitet raporti i shpërndarjes Përfundimtare.

⁵ Raportet përfundimtare – Përgatiten kur komiteti/autoriteti i likuidimit ka procesuar të gjitha kërkesat e pretenduesve, pasi DHPGJSK ka nxjerr vendim që kërkesat janë pranuar apo refuzuar, NSH nuk ka ankesa të pa procesuara, nuk ka asete të pa shitura.

⁶ Agjencia nga muaji shtator i vitit 2014 deri në dhjetor të vitit 2015 ishte pa Bord të Drejtorëve.

- Rreziku** Niveli i ulët i përmbushjes së procesit të likuidimit deri me 31 dhjetor 2016, dhe pengesat e paraqitura, rrisin rrezikun që procesi mos të finalizohet në afatin e përcaktuar kontraktual, njëkohësisht ndikon në rritjen e shpenzimeve për përmbushjen e misionit të AKP-së.
- Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për përmirësimin e performancës që procesi i likuidimit të finalizohet në afatin e përcaktuar kohor.

3.3.2 Shpërndarjet e 20% tek Punëtorët e NSH-ve të shitura

Nga të ardhurat e shitjes së NSH-ve, 20% e atyre të ardhurave u shpërndahet punëtorëve. AKP-ja që nga themelimi i saj kishte transferuar 109,973,567€ në llogarinë e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) për shpërndarjen e 20% të punëtorëve për ndërmarrjet e shitura në vitet paraprake nga kjo, vlera prej 5,728,413 ishte transferuar gjatë vitit 2016.

Çështja 7 - Vonesa në shpërndarjen e 20% tek punëtorët e NSH-ve të shitura - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Gjatë shpërndarjes së 20% tek punëtorët e NSH-ve të shitura, në disa raste kishte vonesa në shpërndarjen e mjeteve në llogari të përfituesve. Vonesat ishin shkaktuar për shkak të pamundësisë në sigurimin e të dhënave të plota për përfituesit. Në listat e dërguara nga AKP në BSPK, mungonin numrat personal të përfituesve. Mungesa e të dhënave të plota në listat e përfituesve për shpërndarjen e 20% tek punëtorët shkaktonte vonesa gjatë procesit të shpërndarjes.
- Rreziku** Mungesa e numrave personal të punëtorëve në listat e shpërndarjes së 20% rrezikon që të ketë transfere në llogari të gabuara dhe vonesa në procesin e shpërndarjes.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se listat e shpërndarjes së 20% tek punëtorët të përmbajnë të dhënat e nevojshme për shpërndarjen e mjeteve në mënyrë të saktë dhe efikase tek përfituesit.

3.3.3 Fondet e mbetura

Sipas raportit të autoritetit të likuidimit të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve, gjendja e fondeve të mbetura pasi që janë zgjedhur të gjitha kërkesat/ ankesat e kreditorëve për NSH e shitura deri me datën 31 dhjetor 2016 ishte 39,456,444€. Agjencia vazhdon të mbajë në mirëbesim këto mjete edhe me tutje për mungesë të një baze ligjore për trajtimin e tyre. Ne e sugjerojmë AKP që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar bazën ligjore, që pas mbylljes së procesit të likuidimit të NSH-ve fondet e mbetura të transferohen nga Agjencia në Qeverinë e Kosovës.

3.4 Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë obligime të papaguara nga operatorët ekonomik ndaj Agjencisë. Gjendja e llogarive të arkëtueshme ishte si në vijim:

Tabela 2 Llogaritë e arkëtueshme sipas llojit dhe viteve në €

Përshkrimi	Llogaritë e arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2015	Llogaritë e arkëtueshme gjatë vitit 2016	Gjendja e llogarive të arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2016
Ndëshkime për spin-off special ⁷	34,437,433€	0.0	34,437,433€
Qira të pa inkasuara	12,542,700€	738,738€	13,281,438€
Shitje e asetëve në privatizim	1,592,134€	4,226,254€	5,818,388€
Gjithsejtë	48,572,267€	4,964,992€	53,537,259€

Gjithsej vlera e llogarive të arkëtueshme deri me 31 dhjetor 2016 ishte 53,537,259€, prej tyre 4,964,992€ i përkasin vitit 2016 ndërsa 48,572,267€ janë të bartura nga vitet paraprake si obligime të papaguara nga operatorët ekonomik ndaj Agjencisë.

Çështja 8 – Shkalla e ulët e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme – Prioritet i lartë

E gjetura

Sipas udhëzimit mbi procedurat e trajtimit të llogarive të arkëtueshme, afati normal për pagesën e llogarive të arkëtueshme është 30 ditë kalendrike, në kontratën përkatëse mund të përcaktohet edhe ndonjë afat tjetër varësisht prej rrethanave, por jo më shumë se 60 ditë.

Me rastin e shitjes të NSH-ve me spin-off special, zotimet për investim dhe punësim kanë qenë faktor i rëndësishëm për zgjedhjen e ofertuesit fitues. Në rast se blerësi nuk i përmbush plotësisht zotimet, brenda periudhës kohore të specifikuar në marrëveshje ndaj tij do të aplikohen ndëshkimet financiare.

AKP kishte aplikuar ndëshkime financiare tek blerësit e NSH-ve për shkak të mos përmbushjes së kushteve të kontratës, megjithatë arkëtimi i tyre është në shkallë të ulët.

Llogaritë e arkëtueshme kishin trend të rritjes edhe gjatë vitit 2016, përkundër rritjes së tyre BD i AKP-së nuk kishte marrë veprimet e nevojshme për trajtimin e llogarive të arkëtueshme, arkëtimin e tyre, apo ndarjen e provizioneve për to.

⁷ Spin-off special - Është njëra nga dy metodat e privatizimit që Agjencia i aplikon, Kjo metodë nënkupton ofertën ekonomikisht më të favorshëm.

- Rreziku** Mos trajtimi i llogarive të arkëtueshme nga BD, trendi i vazhdueshëm i rritjes dhe mos arkëtimi i tyre paraqet rrezik serioz që në të ardhmen të trajtohen si borxhe të këqija. Mënyra e tillë e menaxhimit të llogarive të arkëtueshme dëmton buxhetin e FM.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të hartuar procedura të duhura dhe të qarta për trajtimin me kohë dhe arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5 Obligimet e papaguara

Gjendja e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2016 ishte 1,642,057€. Këto obligime rrjedhin nga dy kategori të ndryshme:

- Kategoria e mallrave dhe e shërbimeve për ofruesit e shërbimeve për NSH-të përkatëse për: shërbimin e ruajtjes së aseteve, shpalljeve në gazeta, furnizime me rryme, ujë, mirëmbajtje, përfaqësim në gjykata, mbeturina, telekomunikim, etj. në vlerë 54,512€; dhe
- Obligimet ndaj kreditorëve të NSH-ve, janë pagesat e pa realizuara ndaj kreditorëve të NSH-ve sipas vendimit të BD të datës 20.12.2016 në vlerë 1,587,545€.

Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

Çështja 9 – Mos raportimi mujor për llogaritë e pagueshme - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Departamenti i financave përgatit raporte në baza mujore për menaxhmetin e lartë të AKP-së, për aktivitetet dhe gjendjen financiare të FM. Ne kemi identifikuar se gjatë vitit 2016 në raportet mujore të dorëzuara nga departamenti i financave tek menaxhmenti nuk ishte raportuar për gjendjen e llogarive të pagueshme. Megjithatë, në PFV ishin raportuar llogaritë e pagueshme.
- Rreziku** Mos raportimi i duhur periodik për llogaritë e pagueshme rritë rrezikun e mos pagesës së obligimeve të papaguara në afatet e përcaktuara kohore dhe rrjedhimisht kontesteve dhe ndëshkimeve për vonesë të pagesave.
- Rekomandimi 9** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që Departamenti i Financave në kuadër të raportimit të rregullt mujor tek menaxhmenti përfshin edhe raportimin e llogarive të pagueshme.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me Pasqyrat Financiare	Kryesuesi i Bordit të rishqyrtojë mundësinë e përfshirjes së shpenzimeve të likuidimit në buxhetin e Agjencisë, në mënyrë që fondet në mirëbesim të mos zvogëlohen përmes transferimeve për ti mbështetur shpenzimet e Agjencisë		Pjesërisht (AKP-ja kishte bërë kërkesë qeverise për fonde shtesë në pajtueshmëri me ligjin e AKP-se mirëpo Qeveria nuk kishte marrë veprime për miratimin e buxhetit për pagesat e OSHP-së).	
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak.	Kryesuesi i Bordit të sigurojë zbatimin e plotë dhe me kohë planin e rishikuar për adresimin e rekomandimeve. Kjo duhet të monitorohet në baza të rregullta kohore dhe arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak duhet të përcaktohen nga zyrtarët relevant dhe t'i raportohen menaxhmentit.		Pjesërisht (planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve dhe kishte përcaktuar departamentet përgjegjëse për adresimin e rekomandimeve).	
3.1.1 Shitja e ndërmarrjeve të reja përmes valëve të privatizimit dhe asetëve përmes likuidimit	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se dokumentacioni i shitjes/ tenderimit përmban informatat e sakta dhe të drejta në veçanti ato për sipërfaqen e objektit të shitjes. Po ashtu, të sigurojë se është analizuar rasti dhe të kuptojë arsyet e paraqitjes së sipërfaqes së gabuar në dokumentacionin e shitjes përfshirë edhe ato të publikuara.	Po është zbatuar		

3.1.2 Të hyrat nga qiratë	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se të gjitha kontratat për qiratë të jenë të nënshkruara nga qiramarrësi.			Nuk ishte zbatuar.
3.2.1 Shpërndarja e 20% punëtoreve të NSH-ve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është bërë marrëveshja me BSPK-në për të siguruar një monitorim dhe harmonizim se shpërndarja e 20% është bërë ashtu siç është pritur.	Po ishte zbatuar (AKP-ja kishte bërë harmonizimin e raporteve për shpërndarjen e 20% punëtoreve me BSPK-në).		
3.2.2 Ofruesi i shërbimeve profesionale	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që OSHP-ja ka shtuar dinamikën e kryerjes së punëve si dhe hartimin e raporteve finale të likuidimit, në mënyrë që procesi i likuidimit të përfundojë brenda afatit kohor të paraparë me kontratë. Po ashtu, të sigurojë që në kontratën eventuale të ardhshme, të parashihet që kërkesat kolektive të së njëjtës natyrë të mos trajtohen si individuale në mënyrë që të kursehet kohë dhe mjete financiare.		Pjesërisht (duke pasur parasysh se në vitin 2015 BD nuk ishte i emëruar, gjatë vitit 2016 BD ishte i emëruar dhe kishte shtuar dinamikën e punëve).	
3.3 Llogaritë e arkëtueshme	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë hartuar afate të qarta kohore për mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe marrjen e masave ligjore për t'i realizuar ato.			Nuk janë marrë masa për të zbatuar rekomandimin.
3.4 Llogaritë e pagueshme	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është ndërtuar një sistem i besueshëm i kontrollit për pranimin e faturave, pagesën e tyre brenda afatit ligjor si dhe prezantimin e obligimeve në PFV.			Nuk janë marrë masa për të zbatuar rekomandimin.

Shtojca IV: Komentet e OB-së për të gjeturat e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e AKP për Fondet në Mirëbesim	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Baza për opinion:</p> <p>Pagesat për OSHP në vlerë prej 3,713,028€, ishin bërë nga mjetet e FM të cilat nuk ishin në pajtueshmëri me Ligjin e AKP-së. Sipas Ligjit të AKP-së pagesat për OSHP duhet të bëhen nga mjetet që i janë ndarë Agjencisë nga Buxheti i Republikës së Kosovës ose nga një donator.</p>	JO	<p>Pagesa e Ofruesve të Shërbimeve Profesionale Agjencia, ashtu si në raportet paraprake, ka paraqitur argumentet ligjore dhe praktikat se përse këto pagesa janë realizuar nga fondi i likuidimit të NSH-ve. Gjithsesi, për këtë çështje (gjetje) të auditorëve e cila është paraqitur edhe më përpara, AKP-ja ka kërkuar buxhet nga Qeveria e Kosovës nga viti 2015, e cila asnjëherë nuk është aprovuar. Vit pas viti kemi paraqitur kërkesën për buxhet shtesë, për këtë të gjetur të auditorit.</p> <p>Gjithashtu argumentet tona të paraqitura edhe më përpara se përse duhet paguar Ofruesi i Shërbimeve Profesionale sipas nenit 40 dhe jo nenit 16 që i referohet Auditori janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpenzimet e Autoritetit të Likuidimit dhe këshilltarëve mbështetës janë të parapara në prioritetin 1.3.2 të nenit 40 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 të AKP-së. Ligji i AKP-së (neni 40 i shtojcës) parasheh që kostot e likuidimit financohen nga fondet e likuidimit (kjo është praktikë ndërkombëtare e financimit të shpenzimeve të administratorit të likuidimit të ndërmarrjeve). Vetëm në rastet kur NSH nuk ka fonde të mjaftueshme, atëherë AKP do të kërkonte buxhet shtesë nga Buxheti i Kosovës apo donatorët (neni 16 	<p>Kjo e gjetur përsëritet nga vitet paraprake dhe rekomandimi i dhënë nga ZKA nuk është implementuar.</p> <p>Sipas nenit 16 të shtojcës së ligjit nr.04/L-034 për AKP-në Kompensimi i Ofruesve të Shërbimeve profesionale. Tarifat dhe shpenzimet e Ofruesit të shërbimeve Profesionale paguhet nga mjetet që i janë ndarë Agjencisë nga buxheti i Republikës së Kosovës ose nga mjetet e siguruara nga një donator. AKP nuk kishte siguruar mjete ne pajtueshmëri me nenin 16 të shtojcës së ligjit për AKP-në. Andaj e gjetura dhe rekomandimi qëndron.</p>

		<p>i shtojcës së ligjit të AKP-së) dhe për këto financime, Agjencia apo donatorët do të kishin të drejtën të kërkonin rimbursim në bazë të prioritetit të përcaktuar në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, gjatë procesit të likuidimit.</p> <p>2. Nëse këto shpenzime do të realizoheshin duke mos i prekur fondet në mirëbesim, por duke përdorë burime të tjera (Agjencisë, Qeverisë apo Donatorëve) atëherë rezultatet do të ishin si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - AKP do të duhej të paraqitej si kreditor i Ndërmarrjes Shoqërore, duke kërkuar rimbursim nga Ndërmarrja Shoqërore në likuidim, në bazë të prioritetit të përcaktuar në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, gjatë procesit të likuidimit; - Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (kontraktori – kompania private) do të duhej të shqyrtonte secilën kërkesë për rimbursim nga AKP-ja dhe do të faturonte Ndërmarrjen Shoqërore me kosto shtesë për shqyrtimin e kërkesave të AKP-së për rimbursim; dhe <p>Me këtë proces do të dëmtohej fondi i likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore duke e ngarkuar me kosto të panevojshme për shkak të kërkesave për rimbursim nga AKP-ja.</p>	
<p>Çështja 3: Zbatimi i ulët i rekomandimeve nga viti paraprak E gjetura - Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të AKP-së ka rezultuar në 8 (tetë)</p>	<p>JO</p>	<p>AKP-ja në vazhdimësi ka bërë adresimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna nga ZKA-ja. Për më tepër, Agjencia ka hartuar planin e adresimit të rekomandimeve jo vetëm për vitin 2015, por edhe për rekomandimet e viteve 2014 dhe 2013. I njëjti</p>	<p>Ne kemi konstatuar se nga 8 rekomandime të dhëna në vitin paraprak, ishin zbatuar vetëm 2 rekomandime, 3 rekomandime pjesërisht, ndërsa 3 rekomandime nuk</p>

<p>rekomandime të FM. AKP kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, vetëm 2 (dy) rekomandime ishin zbatuar, 3 (tri) ishin zbatuar pjesërisht, ndërsa 3 (tri) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim me të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato shihni shtojcën III.</p> <p>Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse nuk është ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së.</p>		<p>plan i adresimit të rekomandimeve të ZKA-së është diskutuar edhe në takimet e Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit.</p>	<p>ishin zbatuar ende.</p> <p>Duke pasur parasysh se vetëm 2 nga 8 rekomandimet e dhëna nga ZKA ishin zbatuar në tërësi, ne e vlerësojmë se ka qenë zbatim i ulët i rekomandimeve të dhëna vitin paraprak. Andaj e gjeturat dhe rekomandimi qëndron.</p>
<p>Çështja 4: Mangësi në kontrollet menaxheriale</p> <p>E gjetura - Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të AKP-së për menaxhimin e FM-së në disa raste ka nxjerrë në pah se kontrollet e brendshme nuk ishin aplikuar në masën e duhur për parandalimin e gabimeve gjatë vitit 2016. Me theks të veçantë, kontrollet nuk ishin efektive në fushën e</p>	<p>JO</p>	<p>Agjencia Kosovare e Privatizimit ka sisteme të mira të kontrolleve menaxheriale, por të cilat në vazhdimësi shtohen dhe modifikohen që të jenë më efektive. Nuk ka asnjë gabim, për ato që është në dijeni Menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve, që sistemet e kontrollit nuk kanë mundur në parandalimin e gabimeve në fushën e shpenzimeve të OSHP-së, llogarive të pagueshme. Gjithashtu, sa i përket inkasimit të arkëtueshme, gjatë vitit 2017 (ashtu si në vitet paraprake) janë ndërmarrë veprime konkrete, të cilat do të rezultojnë në inkasimin e tyre.</p>	<p>Pagesat për OSHP sipas ligjit të AKP-se duhet të behën nga buxheti i AKP-së e jo nga fondet në mirëbesim edhe përkundër inkasimit të llogarive të arkëtueshme krahasuar me vitin paraprak, llogarit e arkëtueshme sipas pasqyrave financiare ishin rritur për 4,964,992€ krahasuar me vitin paraprak. Departamenti i financave nuk kishte raportuar tek menaxhmenti rregullisht për llogaritë e pagueshme. Andaj e gjetura dhe rekomandimi qëndron.</p>

shpenzimeve për pagesat e OSHP-së, përgatitjes së PFV-ve, arkëtimin e të hyrave nga qiratë, arkëtimin nga llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme.			
<p>Çështja 9: Mos raportimi mujor për llogaritë e pagueshme</p> <p>E gjetura- Departamenti i financave përgatit raporte në baza mujore për menaxhmetin e lartë të AKP-së, për aktivitetet dhe gjendjen financiare të FM. Ne kemi identifikuar se gjatë vitit 2016 në raportet mujore të dorëzuara nga departamenti i financave tek menaxhmenti nuk ishte raportuar për gjendjen e llogarive të pagueshme. Megjithatë, në PFV ishin raportuar llogaritë e pagueshme.</p>	JO	<p>Menaxhmenti është i njoftuar për faturat e papaguara e që në të shumtën e rasteve janë raste unike lidhur me arsyet se përse nuk janë paguar. Pagesat nga Fondet në Mirëbesim lidhur me obligimet procesohen shumë shpejt. Ndërsa, vetëm në fund të vitit, mbesin kryesisht, rastet si shkak i prerjes të vitit fiskal të pagesave. Gjithashtu, për rastet që nuk procesohen (rastet që kanë mungesë të plotësimit të dokumentacionit), Menaxhmenti menjëherë njoftohet lidhur me rastin në fjalë dhe kërkohet që të ndërmerren veprime.</p> <p>Për Fondet në Mirëbesim gjithashtu ka elemente të raportimit aty ku ka ngecje të pagesave të pa realizuara të tilla si pagesat ndaj kreditorëve sipas raporteve të shpërndarjes me vendim të Bordit të Drejtorëve.</p> <p>Gjithsesi, Departamenti i Financave dhe Buxhetit së bashku me departamentet e tjera është duke menduar një model të regjistrimit të kërkesës për pagesë dhe procesin e saj deri në ekzekutim të pagesës.</p>	AKP jep sqarime se si menaxhmenti njoftohet për faturat e papaguara, duke mos e kundërshtuar të gjeturën. Andaj e gjetura dhe rekomandimi qëndron.

Aneksi V: Letër konfirmimi

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmojmë se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Fondeve në Mirëbesim, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet për të cilat nuk kemi dhënë komente, ndërsa për të gjeturat të cilat nuk pajtohem, ju lutem referojuni komenteve tona (shih Shtojcën IV: Komentet e AKP-së për të gjeturat e draft-raportit të auditimit të Fondeve në Mirëbesim);
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


z. Ekrem Hajdari
Drejtor Menaxhues
Data: 27.06.2017, Prishtinë,